



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 104/5 Prot.

Tiranë, më 22.04.2024

V E N D I M

Nr.29, Datë 22.04.2024

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit,

VËREJ SE:

Me Urdhrin nr. 11 , datë 30.1.2024 “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin shërbimit civil, në institucionin Autoriteti për Informimin Mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Autoriteti për Informimin Mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), Tiranë.

Administrimi i shërbimit civil në subjektin e mbikëqyrur, si institucion i pavarur, bazohet në nenin 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ku është parashikuar në mënyrë të shprehur se, “fusha e veprimit të tij shtrihet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik, në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur, apo njësi të qeverisjes vendore”.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësi përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, të kryera prej momentit të krijimit të institucionit, e në vijim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 104/1 prot., datë 30.1.2024, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 104/2 prot., datë 30.1.2024, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, i është njoftuar institucionit.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i punës ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 104/3 prot., datë 27.3.2024, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, “Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin institucionin Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”, duke i lënë një afat 5 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i punës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në këtë institucion, janë respektuar kërkesat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, por përgjatë gjithë periudhës së kontrolluar janë vërejtur edhe disa mangësi, të cilat janë vënë në dukje si konstatime në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të tilla si:

→ Komiteti i Përhershëm i Pranimit, nuk ka funksionuar si një i vetëm, për të gjitha procedurat e kategorisë ekzekutive, të shpallura përgjatë vitit.

Njësia përgjegjëse, për ngritjen dhe kohëzgjatjen e këtij organi, duhet të respektojë përcaktimet e Kreut III, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, sipas të cilave, pranë institucioneve të pavarura krijohet një Komitet i Përhershëm i Pranimit, i cili mund të ndryshojë përbërjen vetëm në rastet kur paraqitet nevoja e ndryshimit të ekspertëve të fushës që do të kryhet testimi, ose në rast se ndonjeri prej anëtarëve paraqet pengesa ligjore.

→ Në procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, miratimi nga titullari i institucionit është bërë vetëm në rrugë elektronike (e-mail) dhe jo me vendim ashtu si e kërkon ligji.

Njësia përgjegjëse, për rregullimin e situatës në vjim, duhet të respektojë përcaktimet e nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku citohet se organi kompetent (në këtë rast titullari i institucionit) duhet të shprehet me vendim për pozicionin që do të plotësohet me këtë procedurë. Më pas, vendimin e miratimit të marrë nga titullari i institucionit, ta administrojë në dosjen e planit të rekrutimit për vitin respektiv.

→ Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë nga pikpamja formale, është kryer sipas përcaktimeve të Vendimit nr.109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar. Por, nga ana tjetër, fakti që 75,7% e nëpunësve janë vlerësuar në nivelin 1, “shumë mirë”, që është niveli më i lartë i vlerësimit, si dhe **mungesa e komenteve** në shumicën e rasteve në rubrikat e vlerësimit, cedon objektivitetin e procesit, në drejtim të përmbajtjes së tij, që do të thotë se jemi përpara një procesi administrativ me mangësi në raport me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Zyrtarët vlerësues, Zyrtartari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues, si dhe njësia e burimeve njerëzore, si njësia përgjegjëse që mbikëqyr procesin e vlerësimit, nuk i kanë respektuar të gjitha kërkesat e legjislacionit që rregullon këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil.

Zyrtarët që marrin pjesë në procesin e vlerësimit (zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues/autorizues), për të shmangur vlerësimet subjektive duhet të zbatojnë hap pas hapi të gjitha kërkesat që përcakton Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, të ndryshuar, duke respektuar të gjitha fazat e vlerësimit dhe dokumentimin e tyre në mënyrë shkresore, si nëpërmjet akteve të veçanta, apo të evidentimit të tyre në përmbajtjen e formularit të vlerësimit të punës.

Komisioneri vlerëson se zyrtarët që marrin pjesë në procesin e vlerësimit, duhet të kenë njohuri të plota për realizimin e procedurës së vlerësimit. Të vlerësohen nevojat për trajnimin e tyre me qëllim që procedura e vlerësimit të realizohet në përputhje me standardet e kërkuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.109, datë 26.2.2014, i ndryshuar.

Të hartohet një plan trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta që ju vendos zyrtarëve të vlerësimit legjislacioni i shërbimit civil. Ky plan t’i njoftohet zyrtarisht Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), si dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim që të harohen kurikula të posaçme për të trajnuar zyrtarët e vlerësimit.

Sa parashtruar më sipër, paraqesin disa elementë paregullsie që janë konstatuar nga mbikëqyrja në këtë institucion, të cilat nisur nga natyra e tyre, nuk cenojnë thelbin e proceseve të realizuara. Parregullsitë janë pasqyruar në raport, me qëllim që të sillen në vëmendjen e subjekteve që kanë detyrë të administrojnë shërbimin civil dhe të mos përsëriten në të ardhmen, e ndërkohë do të jenë në fokusin e kontrollit të Komisionerit në vazhdimësi, për të mos lejuar përsëritjen e tyre.

Subjekti i mbikëqyrur, është njohur me projektraportin dhe nëpërmjet shkresës nr. 516/1 prot., datë 11.4.2024, e ka dërguar pranë Komisionerit të nënshkruar nga personat përgjegjës, pa vërejtje, duke u shprehur dakord me të gjitha gjetjet e grupit të punës të pasqyruara në të.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, konstatova se parregullsitë e konstatuara nuk janë të natyrës së shkeljeve ligjore që kërkojnë rregullime të posaçme. Vërejtjet e pasqyruara në këtë akt, janë të karakterit parimor që nuk e cenojnë në thelb ndonjë prej proceseve të evidentuara, e në këto kushte, procesi i mbikëqyrjes nuk do të shoqërohet me vendim paralajmërimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të përfundoj procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion.

Problematikat e evidentuara në përbajtjen e raportit përfundimtar, kanë të bëjnë me aspekte të përgjithshme të zbatimit të ligjit, e për këtë arsye, Komisioneri do të përmbyllë procesin pa vendim paralajmërues. Sqarimi me burimet njerëzore e më tej ndjekja e zbatimit të ligjit në proceset me natyrë të ngjashme që do të kryhen rishtas, do të jetë në vëmendjen e vazhdueshme të stafit të Komisionerit.

2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha